



Përditësim

Mirë se vini në informimin javor të Dhomave të Specializuara të Kosovës, ku synojmë t'u ofrojmë gazetarëve informacion të përditësuar mbi zhvillimet e fundit në Gjykatë dhe mundësinë për të bërë pyetje.

Për arsye humanitare bindëse, Trupi Gjykes dhe Gjykatësja e Procedurës Paraprake udhëzuan Zyrën Administrative të mundësojnë vizitën si i paraburgosur të Hashim Thaçit në Kosovë për t'u takuar me babain e tij. Gjatë vizitës, i akuzuari do të vazhdojë të mbahet në paraburgim dhe nën ruajtje të Dhomave të Specializuara.

Kjo është hera e tretë që panelet e DHSK-së i kanë miratuar kërkesë Hashim Thaçit për vizitë në Kosovë për arsye humanitare bindëse. Në tërësi, kjo është vizita e 13-ë nën ruajtje e një të paraburgosuri në Kosovë e mundësuar nga Zyra Administrative për arsye humanitare.

Në çështjen gjyqësore *Prokurori i Specializuar kundër Hashim Thaçit, Bashkim Smakajt, Isni Kilajt, Fadil Fazliut dhe Hajredin Kuçit*, më 10 mars, Gjykatësja e Procedurës Paraprake hodhi poshtë kërkesën e Mbrojtjes për të apeluar Vendimin Kornizë mbi Trajtimin e Informacionit Konfidencial.

Mbrojtja e z. Thaçi kërkoj të apelonte pjesën e vendimit që i ndalon të kontaktojë "cilindo dëshmitar, viktimë apo person tjetër, identiteti i të cilit është nxjerrë për Mbrojtjen në këtë çështje gjyqësore ose në një çështje gjyqësore tjetër para Dhomave të Specializuara të Kosovës."

Në vendim, Gjykatësja e Procedurës Paraprake rikujtoi se vendimi original "nuk e ndalon Mbrojtësin e z. Thaçi që të kontaktojë ose komunikojë me dëshmitarët që i gjykon se janë relevantë për çështjen gjyqësore, e as nuk e ndalon Mbrojtësin e z. Thaçi, në asnjë formë, të marrë udhëzime nga z. Thaçi ose të konsultohet me të lidhur me përgatitjen e mbrojtjes, për sa kohë që nuk ka kontakt personal midis z. Thaçi dhe personave në fjalë."

Në çështjen gjyqësore *Januzi dhe të tjerët*, më 6 mars 2025, Paneli i Gjykatës Kushtetuese, i përbërë prej gjykatësve Vidar Stensland, Rumen Nenkov, dhe Romina Inkuti, vendosi mbi kërkesën referuese të Haxhi Shalës, ku pretendohet për shkelje të të drejtave themelore të tij.

Në kërkesë, z. Shala pretendon se Gjykatësi i Procedurës Paraprake nuk mori parasysh ligjshmërinë dhe themelësinë e paraburgimit gjatë paraqitjes së parë të tij më 13 dhjetor 2023, pas arrestimit të tij në Kosovë.

Paneli konstatoi se paraqitja e parë e z. Shala u krye në përputhje me nenin 5(3) të Konventës Evropiane për të Drejtat dhe Liritë Themelore të Njeriut. Gjykatësit theksuan se ai u informua mjaftueshëm lidhur me





arsyetimin e Gjykatësit të Procedurës Paraprake për paraburgimin e tij dhe iu dha mundësia për t'u dëgjuar dhe, megjithëse Gjykatësi i Procedurës Paraprake mund të ishte shprehur qartë, vendimi tij nuk sugjeron se ai i anashkaloi aspektet e ligjshmërisë dhe themelësisë së paraburgimit të z. Shala.

Kujtojmë se çështja gjyqësore e Sabit Januzit, Ismet Bahtijarit dhe Haxhi Shalës përfundoi në fillim të këtij viti, pasi të tre të akuzuarit pranuan fajësinë për frikësim gjatë procesit penal dhe pengim të personave zyrtarë gjatë kryerjes së detyrave zyrtare.

Pas miratimit të marrëveshjeve për pranimin e fajësisë në shkurt 2025, z. Januzi dhe z. Bahtijari u dënuan të dy me dy vjet burgim, duke llogaritur kohën e kaluar në paraburgim, dhe z. Haxhi Shala u dënua me tre vjet burgim, gjithashtu duke llogaritur kohën e kaluar në paraburgim.

Në të njëjtën çështje gjyqësore, më 6 mars, Trupi Gjykes hodhi poshtë kërkesën e Mbrojtjes së Haxhi Shalës që gjykatësit të rishikonin vendimin e mëparshëm të Administratores lidhur me nivelin e kompleksitetit të çështjes, në bazë të cilit llogaritet shuma për ndihmë juridike që z. Shala mund të marrë nga DHSK-ja.

Sistemi për ndihmë juridike pasqyron praktikat më të mira të standardeve të ndihmës juridike, duke garantuar respektimin e parimeve të gjykimit të drejtë, dhe duke mundësuar në mënyrë transparente miradministrimin financiar të burimeve të fondeve të ndihmës juridike.

Një të dyshuari ose të akuzuari para DHSK-së që demonstroi se nuk mund të paguajë mbrojtësin, pjesërisht ose plotësisht, i jepet ndihmë juridike për të paguar një avokat që e zgjedh vetë dhe që plotëson kriteret profesionale për t'u pranuar në listën e mbrojtësve të DHSK-së.

Honorari për ndihmë juridike i paguhet drejtpërdrejt mbrojtësit për të mbuluar shpenzimet e mbrojtësit dhe të anëtarëve të tjerë të ekipit. Maksimumi i honorarit të ndihmës juridike llogaritet në bazë të fazës së procesit dhe nivelit të kompleksitetit të çështjes (niveli 1, 2, ose 3).

Në kërkesën e fundit, Mbrojtja e Haxhi Shalës kundërshtoi vendimin e Administratores për t'i caktuar çështjes në fazë gjykimi nivelin e kompleksitetit 2.

Sipas rregullave, gjatë fazës së gjykimit lidhur me krime kundër administrimit të drejtësisë, që rregullohen në bazë të së drejtës vendore, honorari mujor maksimal është 12.675 euro për nivelin e kompleksitetit 2. Shpenzime të tjera krahas këtij honorari përfshijnë, për shembull, ato për përkthime me shkrim dhe me gojë deri në 1.150 euro, 10.250 euro për kontraktim të hetuesve dhe konsulentëve të jashtëm, dhe një shumë e gjithsejtë maksimale prej 10.249 euro për të mbështetur hetimet gjatë të gjitha fazave të procesit.





Në vendimin e tij, Trupi Gjykses rikujtoi se në kuadër të marrjes së vendimit, Administratorja kishte shqyrtuar në hollësi të gjitha kriteret e zbatueshme që përmban Rregullorja për Ndhimë Juridike dhe dha arsyet pse gjykoi se kjo çështje në fazë të gjykimit duhet të vlerësohet se ka nivelin e kompleksitetit 2.

Në të njëjtën çështje gjyqësore, më 5 mars 2025, Mbrojtësja e Ismet Bahtijarit i dorëzoi një kërkesë Kryetares së DHSK-së, Ekaterina Trendafilova, ku i kërkoi të sqaronte dhe/ose të ndryshonte tre kushte të lirimit me kusht të z. Bahtijari.

Kujtojmë se, pasi Sabit Januzi dhe Ismet Bahtijari vuajtën dy të tretat e dënimeve përkatëse me nga dy vjet burgim, Kryetarja e DHSK-së vendosi të ndryshonte dënimet për të mundësuar lirimin e tyre me disa kushte të rrepta.

Në kërkesën e fundit, Mbrojtja e Bahtijarit i kërkoi Kryetares të sqaronte dhe/ose të ndryshonte kushtet specifike që:

- “të mos kontaktojë ose komunikojë me viktimën 1 dhe të afërm të tjerë”;
- “të mos kontaktojë apo komunikojë me dëshmitarë (të mundshëm) ose viktima para DHSK-së dhe ZPS-së;” dhe
- “të mos bëjë komente të dhunshme, frikësuese, kërcënuese ose shtrënguese ndaj ose rreth dëshmitarëve (të mundshëm) ose personave të tjerë që janë të rrezikuar për shkak të bashkëpunimit të tyre me DHSK-në, zyrtarëve të DHSK-së ose ZPS-së”.

Më 7 mars, Kryetarja e DHSK-së lëshoi vendimin me të cilin hodhi poshtë kërkesën duke theksuar se, “Mbrojtësja e z. Bahtijari nuk kërkon sqarim në lidhje me kushtet tashmë të përcaktuara qartë, por thjesht nuk pajtohet përgjithësisht me llojin dhe kuadrin e tyre, si dhe me rrjedhojat që kanë për nivelin e komunikimit të z. Bahtijari me personat e përmendur në Vendimin e Modifikimit.”

Pyetjet e bëra

Një gazetar kërkoi më shumë detaje në lidhje me vizitën nën mbikqyrje të Hashim Thaçit, ndërsa zëdhënësi u përgjigj se nuk ka informacion publik shtesë lidhur me këtë.

